



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:048408
Datë: 14.06.2024
Numri i dokumentit: 05825645

C.nr.221/23

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtari Gazmend Ajvazi, me bashkëpunëtoreshen profesionale Bionda Rexhepi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E.H. nga fshati ..., komuna e Gjilanit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson M.N., avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, me objekt kontesti kompensimi i shpërblimit dhe të drejtave të tjera, me vlerë të kontestit 610.50 euro, jashtë seancës, me datë 04.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi e pabazuar kërkesëpadia e paditësit E.H. nga fshati ..., komuna e Gjilanit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit, që mbi bazën e kontratës për veprën, për periudhën kohore 16.11.2022 – 30.11.2022, t’ia kompensojë shumën bruto prej 203.50 euro dhe për periudhën kohore 01.12.2020 – 31.12.2022, t’ia kompensojë shumën bruto prej 407.00 euro, apo shumën e përgjithshme prej 610.50 euro, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga dita e shkaktimit të dëmit më datë 16.11.2022, e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditë, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm ligjor.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, më datë 21.02.2023 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurave për kompensimin e shpërblimit dhe të drejtave të tjera, në vlerë të kontestit prej 610.50 euro.

Në padi ka theksuar se i njëjti më datë 18.10.2022 kishte lidhur kontratë për veprën me palën e paditur, e cila kishte cilësinë e porositësit të punëve, ndërsa paditësi kishte cilësinë e “inspektorit të ndërtimit”. Kjo kontratë është lidhur në afat të caktuar për periudhën kohore 18.10.2022 – 31.12.2022, ndërsa e paditura ka qenë e detyruar të paguaj shpërblimin mujor në shumë bruto prej 407.00 euro, duke i ndalur tatimin në burim. Palët janë dakorduar si në nenin 6 të kontratës që e njëjta të shkëputet me skadimin e afatit të paraparë kontraktues. E paditura njëanshëm ka ndërprerë kontratën, nën arsyetimin se ka pushuar nevoja e angazhimit të mëtejshëm të paditësit,

pa asnjë paralajmërim për palën paditëse, duke shkelur obligimin kontraktues. Për këtë shkak, paditësi më datë 01.12.2022 i është drejtuar të paditurës me kërkesë për kompensimin e mjeteve financiare që burojnë nga detyrimi kontraktues, mirëpo e paditura përmes përgjigjes të datës 02.12.2022 ka refuzuar kërkesën e paditësit. Nga të lartcekurat, gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyroj të paditurën në kompensimin e shumës prej 610.50 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 104.00 euro, për përpilim të padisë dhe 20.00 euro, për taksë gjyqësore.

E paditura në përgjigje në padi ka deklaruar se e kundërshton të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se përmes zyrës së kryetarit, paditësi është njoftuar se nga data 16.11.2022 i ndërpritet kontrata e datës 19.10.2022, me arsye se për punët dhe detyrat që rrjedhin nga kjo kontratë kanë përfunduar apo pushuar nevojat për një angazhim të tillë. Më datë 02.12.2022, e paditura i ka kthyer përgjigje paditësit në kërkesën e tij për kompensimin monetar, duke i sqaruar se përmes këtij raporti kontraktual nuk vlejnjë asnjë prej pasojave juridike të cilat dalin nga marrëdhëniet e punës që rregullohen me Ligjin e Punës. Njëkohësisht edhe ndërprerja ka ardhë duke u bazuar në nenin 70 të këtij ligji. Ka theksuar se nuk mund të merret shpërblim për punën që nuk është bërë sepse me pushimin e marrëdhënies së punës pushojnë edhe të drejtat që rrjedhin prej saj. Gjykatës i ka propozuar të refuzojë të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 399, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia. Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësi ka lidhur kontratë mbi veprën me të paditurën dhe janë dakorduar që periudha kontraktuese të jetë 18.10.2022 – 31.12.2022, paga bruto për një muaj të jetë 407.00 euro dhe që kontrata të konsiderohet e shkëputur me skadimin e afatit të paraparë kontraktues (kontrata 02.nr.1112 e dt.19.10.2022); se e paditura më datë 15.11.2022 i ka ndërprerë kontratën e punës paditësit që nga data 16.11.2022 (njoftimi 02.nr.016-133297 i dt.15.11.2022 dhe 02-016-133577 i dt.16.11.2022); dhe se më datë 02.12.2022 është refuzuar kërkesa e paditësit për kompensimin monetar, në të cilën edhe është përshkruar se pagesën/shpërblimin e angazhimit të paditësit deri më datë 15.11.2022 e kanë realizuar, ndërsa pagesa tutje deri më datë 31.12.2022 është e pabazuar (email i datës 02.12.2022, ora 09:42).

Në Ligjin e Punës, neni 10, paragrafi 6, 7 dhe 8 është përcaktuar se “Kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë se njëqindnjëzet (120) ditë brenda një (1) viti. 7. Personi që ka lidhur kontratë të punës për një afat të caktuar ose për një detyrë specifike, i ka të gjitha të

drejtat dhe detyrimet e parapara me këtë ligj, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj. 8. Të punësuarit për një punë specifike, nuk i takon e drejta në pushim vjetor dhe të drejtat e tjera të përcaktuara me Kontratë Kolektive dhe Kontratën e Punës”; dhe neni 55, paragrafi 1 dhe 2 se “I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit . 2. Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuar i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës”.

Meqenëse objekt shqyrtimi i kësaj çështje kontestuese është kompensimi monetar nga marrëdhënia e punës, e jo anulimi i vendimit/njoftimit të të paditurës, gjykata vlerëson se në rastin konkret gjen zbatim neni 87 të Ligjit të Punës, prandaj edhe kërkesa e paditësit është e afatshme.

Bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar, e cila nuk ishte kontestuese mes palëve në kontest, se paditësi me të paditurën kanë lidhur kontratë për vepër më datë 19.10.2022, për periudhën e caktuar prej 18.10.2022 – 31.12.2022, ndërsa me njoftimin e të paditurës, kontrata është ndërprerë nga data 16.11.2022, me ç’rast paditësi ka punuar vetëm për periudhën 18.10.2022 – 16.11.2022, gjykata bazuar në nenin 55.2 të LP-së, vendosi të refuzojë të pabazuar kërkesën e paditësit për kompensimin monetar për periudhën 16.11.2022 – 31.12.2022, periudhë kjo për të cilën paditësi nuk ka punuar.

Gjykata vlerëson se kompensimi monetar gjen zbatim vetëm në rast se i punësuar, këtu paditësi ka realizuar sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, ndërsa nga gjendja faktike konstatohet se paditësi nuk ka punuar për periudhën të cilën kërkon të kompensohet, prandaj as nuk mund t’i takojë ky kompensim.

Nga kjo arsye, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, pasi përkundër suksesit të të paditurës në procedurë, e njëjta nuk i kërkoi shpenzimet e procedurës.

Nga të lartcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.221/23, datë 04.06.2024

Gjyqtari,
Gazmend Ajvazi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.